



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

**INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS**

**TRANSPARENCY
INTERNATIONAL
KOSOVA**

KORRIK 2018

INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK 2017

PËR KOMUNAT E KOSOVËS



TRANSPARENCA DHE
KUNDËRKORRUPSIONI



KORRIK 2018

INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK 2017

PËR KOMUNAT
E KOSOVËS

|||||



COPYRIGHT © 2018. Kosova Democratic Institute (KDI).

Institutit Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo koment, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Street Bajram Kelmendi, no. 45,
10000, Prishtina, Kosovë
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Punuar nga: Diana Metushi Krasniqi

Me asistencë hulumtuese të: Fjolla Uka dhe Elira Tahiri

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës - Transparency International Kosovë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
METODOLOGJIA	10
QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE	12
TRANSPARENCA BUXHETORE	15
TRANSPARENCA NË PROKURIM	20
TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE	24
IIFORMATA NË SHKALLËN E PARË TË ANKESAVE LIDHUR ME PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK ..	26
KONKLUZIONE	28
SHTOJCA 1.....	32

“

“Objektivi i qeverisë është mirëqenia e popullit. Prosperiteti dhe progresi material i një kombi janë të dëshirueshme, për sa kohë që ato çojnë në mirëqenie morale dhe materiale të të gjithë qytetarëve të mirë.”

(THEODORE ROOSEVELT)

HYRJJE

Gjatë viteve të kaluara, Qeveria e Kosovës e ka përmirësuar menaxhimin dhe transparencën e shpenzimeve publike duke inkorporuar direktivat e BE-së për prokurim publik¹ në kornizën ligjore dhe rregullative, duke rritur pjesëmarrjen e publikut², duke ndërtuar programe të trajnimit,³ dhe duke lansuar një platformë elektronike të prokurimit.⁴ Kjo reformë më e fundit, në mënyrë të veçantë, ka shtuar nivele të reja të transparencës në procesin e prokurimit.

1 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

2 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Aktet nënligjore: Rregullorja (GRK) nr. 01/2016 për shqyrtimin administrative të akteve komunale, Rregullorja nr. 02/ 2017 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave, Rregullorja (MAPL) nr. 01/2017 për procedurën për hartimin dhe publikimin e akteve komunale; Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencave të komiteteve këshilldhënëse në komuna; Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 01/2015 për transparence në komuna.

3 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 25

4 E-Prokurimi; FreeBalance, <http://opendata.rks-gov.net>, etj.



“SHPENZIMET PUBLIKE DHE Mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës.”

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
NENI 120

DOBITË E TRANSPARENCËS

- Rritja e besimit në qeverisje të mirë përmes llogaridhënies në shpenzimet publike;
- Rritja e konkurrencës duke iu dhënë operatorëve ekonomik mundësinë për planifikime dhe përgatitje paraprake për kërkesat e identifikuar
- Rritja e llogaridhënies duke mundësuar analiza krahasuese të nevojës dhe realizimit, ose devijimit nga këto plane;
- Forcimi i përpjekjeve për luftimin e korrupsionit duke zvogëluar mundësitë e dhënies së informatave shtesë dhe rregullimet e çmimeve nga institucionet publike me operatorë të caktuar ekonomikë;
- Ngritja e kapaciteteve përmes kritikës konstruktive, e cila do të ndihmonte institucionet në përmirësimin e qeverisjes;
- Rritja e efikasitetit përmes zvogëlimin të mundësive për korrupsion dhe keqpërdorim.



Platforma e prokurimit elektronik siguron që të gjithë ofertuesit të kenë të njëjtat informata dhe zvogëlon mundësinë e individëve që të manipulojnë tenderët për përfitim personal. Nga 1 janari 2017, të gjitha komunat u urdhëruan që të përdorin platformën e prokurimit elektronik për të publikuar të gjithë tenderët për prokurimet e vogla, të mesme dhe të mëdha, obligim që e kanë respektuar në shkallën prej 100%.

Transparency International ka cekur progresin e Kosovës në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (IPK) për vitin 2017.⁵ Në IPK, rezultati i Kosovës është përmirësuar për 10 pikë nga viti i kaluar⁶, duke çuar në një rangim të ri në pozitën e 85-të nga 180 vende që janë vlerësuar.

Përkundër këtyre përmirësimeve në transparencën qeverisëse, ky Indeks i Transparencës për Prokurimin Publik për Komunat e Kosovës tregon se ende ka hapësirë për përmirësim. Për shembull, përkundër faktit se të gjitha prokurimet e komunave bëhen përmes platformës së prokurimit elektronik, komunave ende u kërkohet me ligj që të publikojnë informata e prokurimit në faqet e tyre të internetit; megjithatë, kjo praktikë duket të ketë pësuar rënie në vitin 2017 krahasuar me vitet e mëhershme. Në disa raste, kjo ishte për shkak se komunat kishin telashe me faqe të dobëta ose jofunksionale të internetit si rezultat i një projekti për të përmirësuar dhe standardizuar faqet e internetit të komunave i filluar nga qeveria qendrore e që është jashtë kontrollit të komunave. Në disa raste, zyrtarët komunalë të prokurimit nuk ishin në dijeni se informatat e prokurimit duhej të publikohen edhe në platformën e prokurimit publik edhe në faqen e internetit të komunave. KDI po ashtu ka konstatuar se faqeve të internetit të komunave u mungon konsistenca dhe qartësia në prezantimin e informative të prokurimit publik. Më tej, KDI ka gjetur se shumë komuna nuk i kanë përmbushur kushtet ligjore për dëgjime publike, duke e humbur kështu një mundësi të mirë për shkëmbim të informatave rreth projekteve dhe planeve të prokurimit me publikun.

5 https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017

6 http://issuu.com/transparencyinternational/docs/2016_cpireport_en?e=2496456/43483458

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) vlerëson se 20-30% e vlerës së projekteve mund të humbas në prokurimet e qeverisë kur ka korrupsion.⁷ Prandaj, për tu siguruar që komunat e Kosovës të arrijnë vlerën maksimale për paratë për qytetarët e tyre, është shumë me rëndësi të jenë sa më transparente që të jetë e mundur.

Nivelet e transparencës në prokurimin publik mund të vazhdojnë të përmirësohen, por vonesat ose refuzimet e qasjes në dokumente publike i kufizojnë mundësitë e qytetarëve, shoqërisë civile, dhe mediave që të monitorojnë në mënyrë efektive procesin e prokurimit publik dhe që të mbajnë përgjegjës zyrtarët lokalë. Pa mekanizma plotësisht funksionalë të llogaridhënies, pasojat e keqpërdorimeve nga zyrtarët, dhe keqmenaxhimit në nivelin komunal i bartin qytetarët e Kosovës.⁸

Përmes publikimit të rregullt të këtij Indeksi të Transparencës, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/Transparency International Kosovë (TIK) synon të hedh dritë mbi aktivitetet e prokurimit komunal e me këtë të stimulojë institucionet që të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. Qëllimi i këtij Indeksi është që të informojë qytetarët rreth niveleve të transparencës dhe efikasitetit me të cilat qeveritë lokale janë në gjendje të ofrojnë mallra, punë dhe shërbime dhe që të inkurajojë institucionet që të zhvillojnë prokurime efikase dhe transparente. Transparenca më e mirë dhe qasja në informata rreth shpenzimeve publike do t'i mundësonin publikut që të kuptojë se si shpenzohen taksat e tyre.

7 OECD Parandalimi i Korrupsionit në Prokurimin Publik, 2016

8 KTV, Qeveria ia mohon KTV-së qasjen në kontratën publike për autostradën "Prishtinë-Shkup", lajmet e mbrëmjes 09 korrik 2018; Instituti RIINVEST, Kontratat e Dëmshme të Kosovës, korrik 2018; Instituti RIINVEST, Sa është e hapur Qeveria e Kosovës? Rezultatet e Matësit të Qeverisë së Hapur në Kosovë, 2016; KDI, Transparentitis Virus, 2016





NË KOSOVË, KOMUNAT SHPENZOJNË
MESATARISHT

40-60%

**TË BUXHETEVE TË TYRE PËRMES
PROKURIMIT PUBLIK.**

KUR MUNGON TRANSPARENCA OSE
LLOGARIDHËNIA, PROKURIMI KOMUNAL
MUND TË JETË SHUMË I CENUESHËM NGA
KORRUPSIONI. SIPAS TRANSPARENCY
INTERNATIONAL, MEKANIZMAT KYÇ NË LUFTËN
KUNDËR KORRUPSIONIT JANË KORNIZA
ADEKUATE LIGJORE, PJESËMARRJA E PUBLIKUT,
TRANSPARENCA, KONTROLLET E BRENDSHME,
MBIKËQYRJA PUBLIKE, DHE TRAJNIMI.

METODOLOGJIA

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) degë e Transparency International (TI) për Kosovë ka zhvilluar një metodologji të matjes së transparencës në fushën e prokurimit publik për të gjitha institucionet lokale dhe qendrore. Metodologjia e tillë për herë të parë është zbatuar në vitin 2014 kur është bërë matja e parë transparencës së komunave në katër shtylla tematike. Me ndryshimet ligjore në Ligjin për Prokurim Publik, KDI e ka shtuar edhe një shtyllë në metodologjinë paraprake, që e mat transparencën në prokurim dhe shpenzime komunale në pesë (5) shtylla kryesore dhe në 19 indikatorë të ndryshëm si vijon:

SHTYLLA 1: QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DO TË MATET ME:

- 1 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike, në çdo fushë;
- 2 Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike, në çdo fushë;
- 3 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike, në fushën e prokurimit publik;
- 4 Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumentet publike në fushën e prokurimit publik.

SHTYLLA 2: TRANSPARENCA BUXHETORE:

- 5 Publikimi i buxhetit të aprovuar për vitin 2017 në ueb faqen e komunës;
- 6 Publikimi i planit të prokurimit për vitin 2017 në ueb faqen e komunës;
- 7 Publikimi i raporteve të auditimit për vitin 2016 në ueb faqe e komunës;
- 8 Numri i dëgjimeve publike;
- 9 Publikimi i raporteve financiare tremujore dhe gjashtëmujore/vjetore në ueb faqe.

SHTYLLA 3: TRANSPARENCA NË PROKURIM PUBLIK:

- 10 Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqen e komunave (njoftimet për kontratë);
- 11 Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- 12 Numri i fituesve të shpallur në ueb faqen e komunës (njoftimet për dhënie të kontratës);
- 13 Numri i fituesve të shpallur në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.



SHTYLLA 4: TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE:

- 14 Njoftimet për shpallje të ankandit publik në ueb faqen e komunës;
- 15 Njoftime për shpallje të ankandit publik në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- 16 Njoftimi për fituesit e ankandit në ueb faqen e komunës;
- 17 Njoftim për fituesit e ankandit në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

SHTYLLA 5: INFORMATAT MBI ANKESAT NË SHKALLËN E PARË LIDHUR ME PROCESIN E PROKURIMIT PUBLIK:

- 18 Numri i kërkesave/ankesave të Operatorëve Ekonomik për rishqyrtim të vlerësimeve për dhënie të kontratave;
- 19 Numri i vendimeve (përgjigjeve) në kërkesat për rishqyrtim.



Ky Indeks i Transparencës mbulon të 38 Komunat e Kosovës

SQARIM

Gjatë vitit 2017, komunat e Gjakovës, Klinës, Ferizaj, Hanit të Elezit dhe Mitrovicës Veriore nuk kanë pasur ueb faqe funksionale, prandaj për këto komuna nuk kemi pasur të dhëna të disponueshme në shtyllat 2, 3 dhe 4.





QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Indeksi i Transparencës në Shtyllën e parë e mat qasjen në dokumente publike. Përmes kësaj shtylle, KDI ka vëzhguar shkallën se sa zbatohet Ligji për Qasje në Dokumente Publike. Përveç kësaj, KDI ka vlerësuar mundësinë e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile dhe mediave që të shfrytëzojnë këtë mekanizëm për të kërkuar llogari nga institucionet komunale.

Në fokus ishin kërkesat për qasje në dokumente publike që lidhen me prokurimin publik. Sipas të dhënave që janë ofruar nga komunat pas kërkesës nga KDI, në të gjitha komunat qytetarët kanë bërë 939 kërkesa për qasje në dokumente publike në vitin 2017.

Prej këtyre kërkesave, 335 kanë qenë të lidhura me prokurimin publik. Komunat me numrin më të madh të kërkesave për qasje në dokumente publike, sipas të dhënave tona ishin Prishtina me 166 kërkesa, Klina me 105, Lipjani me 68, dhe Drenasi dhe Prizreni me nga 61 kërkesa.

Vetëm 29 nga 38 komunat i janë përgjigjur anketës së KDIs-ë duke ofruar të dhëna mbi aktivitetet e tyre në zbatim të ligjit për qasje në dokumente publike. 9 komuna më poshtë nuk u janë përgjigjur kërkesave për informata rreth qasjes qasjes në dokumente publike gjatë vitit 2017.



SIPAS TË DHËNAVE QË JANË OFRUAR NGA KOMUNAT PAS KËRKESËS NGA KDI, NË TË GJITHA KOMUNAT QYTETARËT KANË BËRË 939 KËRKESA PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE NË VITIN 2017. PREJ KËTYRE KËRKESAVE, 335 KANË QENË TË LIDHURA ME PROKURIMIN PUBLIK.





NUMRI I KËRKESAVE PËR QASJE TË DËRGUARA NGA KDI TEK KOMUNAT DHE PËRGJIGJET NË KËRKESA



KOMUNAT QË NUK JANË PËRGJIGJUR NË KËRKESAT PËR INFORMATA

- | | | |
|------------------|-----------------------------|----------------------|
| 1 DRAGASH | 4 LEPOSAVIQ | 7 SHTËRPCË |
| 2 JUNIK | 5 MITROVICË E VERIUT | 8 ZUBIN POTOK |
| 3 KLLOKOT | 6 RANILUG | 9 ZVEÇAN |

TABLE 1. Komunat që nuk janë përgjigjur në kërkesat për informata



TË DHËNAT NGA KOMUNAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

	Nr. total i kërkesave për vitin 2017	Nr. total i kërkesave të refuzuara për 2017 ⁹	Nr. i kërkesave të lidhura me prokurim publik 2017	Nr. i kërkesave të refuzuara për prokurim publik
1 Deçan	10	1	2	0
2 Dragash			Nuk ka ofruar informacion	
3 Drenas	61	2	3	0
4 Ferizaj	55	5	37	0
5 Fushë Kosovë	24	0	13	0
6 Gjakovë	35	0	20	0
7 Gjilan	41	0	3	0
8 Graçanicë	9	0	0	0
9 Hani i Elezit	11	0	3	2
10 Istog	47	0	20	0
11 Junik			Nuk ka ofruar informacion	
12 Kaçanik	7	0	5	0
13 Kamenicë	14	1	8	0
14 Klinë	105	19	11	0
15 Klokot			Nuk ka ofruar informacion	
16 Lipjan	68	1	45	0
17 Malishevë	27	0	4	0
18 Mamushë	24	0	10	0
19 Mitrovicë	18	0	0	0
20 Mitrovicë e Veriut			Nuk ka ofruar informacion	
21 Novo Bërdë	4	0	0	0
22 Obiliq	13	2	2	0
23 Partesh	0	0	0	0
24 Pejë	14	0	8	0
25 Podujevë	19	2	10	0
26 Prishtinë	166	0	43	0
27 Prizren	61	0	42	0
28 Rahovec	10	0	2	0
29 Ranillug			Nuk ka ofruar informacion	
30 Shtërpcë			Nuk ka ofruar informacion	
31 Shtime	45	0	19	0
32 Skenderaj	6	1	2	0
33 Suharekë	27	0	15	0
34 Viti	11	1	2	0
35 Vushtrri	7	0	6	0
36 Leposaviq			Nuk ka ofruar informacion	
37 Zubin Potok			Nuk ka ofruar informacion	
38 Zvečan			Nuk ka ofruar informacion	
Total	939	35	335	2



TRANSPARENCA BUXHETORE

Procesi i përcaktimit të buxhetit të komunave ua mundëson qeverive lokale që të planifikojnë shfrytëzimin e resurseve të kufizuara financiare për tu ofruar qytetarëve vlerë, përfshirë edhe përmes zbatimit të kontratave publike për mallra, punë ose shërbime.

Në këtë shtyllë KDI ka matur transparencën buxhetore të komunave. Planifikimi buxhetor në nivel komunal përfshinë prokurimin për investime kapitale, shërbime apo mallra.

PËR TË MATUR TRANSPARENCËN BUXHETORE, KDI KA PËRDORUR INDIKATORËT E MËPOSHTËM:

- 1 Publikimi i dokumentit të buxhetit në ueb faqen e komunës;
- 2 Publikimi i planit të prokurimit në ueb faqen e komunës;
- 3 Publikimi i raporteve të auditimit në ueb faqen e komunës;
- 4 Numri i dëgjimeve publike në vitin 2017;
- 5 Numri i raporteve të shpenzimeve financiare gjatë periudhës janar- dhjetor 2017 të publikuara në ueb faqen e komunës.





LISTA E KOMUNAVE QË KANË PUBLIKUAR BUXHETIN PËR VITIN 2017

- 1 Dragash

- 2 Drenas

- 3 Istog

- 4 Kaçanik

- 5 Kamenicë

- 6 Lipjan

- 7 Malishevë

- 8 Mitrovica

- 9 Novo Bërdë

- 10 Pejë

- 11 Prishtinë

- 12 Prizren

- 13 Rahovec

- 14 Shtime

- 15 Skenderaj

- 16 Suharekë

- 17 Viti

- 18 Vushtrri

PUBLIKIMI I BUXHETIT TË APROVUAR NË UEB FAQE

Në periudhën prej janarit deri më dhjetor 2017, 53% e komunave nuk kishin publikuar planet e tyre buxhetore në ueb faqet e tyre. Nga 38 komuna, vetëm 18 kishin publikuar buxhetin.

Sipas Udhëzimit Administrativ 01/2015 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të gjitha komunat janë të obliguara me ligj që të publikojnë buxhetin, planin e buxhetit dhe planin e investimeve. Publikimi i buxhetit nga komunat ndihmon qytetarët që të shohin se si shpenzohen taksat e tyre. Përmes buxhetit qytetarët do të jenë në gjendje të kuptojnë nëse rruga, lagjja apo bashkësia territoriale e tyre do të jetë pjesë e planeve të të zgjedhurve të tyre. Përmes transparencës në buxhet komunat duhet të informojnë qytetarët për investimet e ardhshme në komunën e tyre. Kjo po ashtu do të ndihmon edhe bizneset që të përgatiten në mënyrë më efektive për të marrë pjesë në investimet publike.



PLANIFIKIMET E PROKURIMIT NË UEB FAQE

Në mënyrë ideale, komunat hartojnë planet e tyre të prokurimit përmes një procesi të prioritizimit të nevojave të qytetarëve për investime kapitale, mallra, punë ose shërbime. Përmes procesit të planifikimit të prokurimit, vendimmarrësit komunalë përcaktojnë metodat e prokurimit dhe pritjet për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Planifikimet e prokurimit janë të rëndësishme sepse një plan i prokurimit paraqet të gjitha kërkesat e pritshme që do të prokurohen gjatë një periudhe, përcakton një afat kohor të realizimit të këtyre prokurimeve, si dhe parashikimet e vlerës së prokurimeve. Përveç që ky planifikim ofron mundësinë e konsolidimit të prokurimit të artikuljuve të ngjashëm apo me interes të përbashkët, ky proces i planifikimit, kur të publikohet, u jep një mundësi bizneseve që të bëjnë planet dhe përgatitjet e nevojshme për qasje në prokurim publik dhe që ofertat e tyre të jenë sa më konkurruese. Publikimi i këtij plani në uebfaqen e komunës po shut është kërkesë e Udhëzimit Administrativ 01/2015 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.¹⁰



¹⁰ Udhëzimi Administrativ i MAP-së 01/2015: [https://map.rks-gov.net/getattachment/5409918d-193e-4372-88b6-3ba29358bc89/Udhëzimi-Administrativ-\(MAP\)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx](https://map.rks-gov.net/getattachment/5409918d-193e-4372-88b6-3ba29358bc89/Udhëzimi-Administrativ-(MAP)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx)

KOMUNAT QË KANË PUBLIKUAR PLANIFIKIMIN E PROKURIMIT

1	Kamenicë	6	Prishtinë
2	Klinë	7	Rahovec
3	Lipjan	8	Viti
4	Malishevë	9	Vushtrri
5	Podujevë		

Sipas legjislacionit sekondar paraprak për Prokurimin Publik (A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik¹¹, i cili ishte në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit, publikimi i planeve të prokurimit ishte i ndaluar nën pretekstin se publikimi i vlerave të parapara të prokurimeve do të rezultonte në humbjen e vlerës së tregut, dhe operatorët ekonomikë do të ofertonin çmime sa më të përafërta me vlerat e parashikuara buxhetore. Kjo dispozitë ishte në konflikt të drejtpërdrejt me kërkesat e përcaktuara nga Ministria e Administratës Publike për përmbajtjen minimale të faqeve të internetit të institucioneve publike. Megjithatë, nga 38 Komunat e vlerësuara, nëntë komuna janë treguar pro aktive, duke publikuar planet e prokurimit në formë të njoftimit paraprak, apo me çmime të redaktuara. RRUOPP u ndryshua në fillim të vitit 2018 për të mundësuar publikimin e planeve të prokurimit. (Shih më lartë listën e komunave që kanë publikuar planet e tyre të prokurimit).

¹¹ https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=StdForms&LID=1&P-PRCMenu_OpenNode=62



RAPORTI I AUDITORIT NË UEB FAQE

Publikimi i raportit të auditimit për vitin 2016 është një tjetër indikator me rëndësi, pasi në këtë formë i ofron publikut të dhëna se si janë menaxhuar paratë publike nën menaxhimin e komunës. Pjesa më e madhe e komunave ende nuk i publikojnë raportet e auditimit në ueb faqet e tyre.

Duhet të ceket se raportet e auditimit për të gjitha komunat gjenden në faqen e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Megjithatë, komunat prapëseprapë janë të obliguara të publikojnë raportet e auditimit në ueb faqet e tyre sipas Udhëzimit Administrativ 01/2015 të MAPL-së për transparencën e qeverisjes lokale.¹²



LISTA E KOMUNAVE QË KANË PUBLIKUAR RAPORTIN E AUDITORIT

1 Dragash

2 Drenas

3 Lipjan

4 Malishevë

5 Prishtinë

6 Prizren

7 Rahovec

8 Shtime

9 Vushtrri



26 KOMUNAT TË CILAT I JANË PËRGJIGJUR KËRKESËS PËR INFORMATA, GJATË VITIT 2017, **KANË ORGANIZUAR 238 DËGJIME PUBLIKE**

¹² Udhëzimi Administrativ i MAPL-së 01/2015: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11403>



NUMRI I DËGJIMEVE PUBLIKE 2017

Komunat janë treguar mjaft aktive sa i përket dëgjimeve publike. Numri i kërkuar i dëgjimeve publike është së paku dy për qarkoren buxhetore si pjesë e degjimeve buxhetore. Sipas të dhënave të pranuar nga 26 komunat të cilat i janë përgjigjur kërkesës për informata, gjatë vitit 2017, këto komuna kanë organizuar 238 dëgjime publike, nga të cilat komunat në vijim kanë qenë më aktivet:

KOMUNA	NR. I DEGJIMEVE PUBLIKE 2017
PRISHTINË	24
VITI	24
RAHOVEC	17
LIPJAN	16
GJILAN	15
GJAKOVË	14

Megjithatë, vetëm 54% të njoftimeve për këto dëgjime publike janë të publikuar edhe në ueb faqet komunale.

NUMRI I RAPORTEVE TË SHPENZIMEVE FINANCIARE JANAR- DHJETOR 2017

Korniza aktuale ligjore kërkon që të publikohen raportet tremujore dhe vjetore të shpenzimeve nga të gjitha institucionet publike. Gjatë vitit 2017, 21 komuna kanë publikuar gjithsej 74 raporte tremujore, gjashtë mujorshe apo vjetore të publikuara ueb faqe e tyre komunale. Komunitat që kanë publikuar katër raporte në vit janë konsideruar se kanë përmbushur kushtin themelore ligjor për këtë indikator. Në vitin 2017 Prishtina ishte komuna që ka udhëhequr në publikimin e raporteve mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore të shpenzimeve.

KOMUNA	NR. I RAPORTEVE TË SHPENZIMEVE FINANCIARE JANAR- DHJETOR 2017
DEÇAN	0
DRAGASH	4
DRENAS	0
FERIZAJ	0
FUSHË KOSOVË	0
GJAKOVË	0
GJILAN	2
GRAÇANICË	0
HANI I ELEZIT	4
ISTOG	1
JUNIK	2
KAÇANIK	1
KAMENICË	0
KLINË	3
KLLOKOT	0
LIPJAN	4
MALISHEVË	4
MAMUSHË	0
MITROVICË	1
MITROVICË E VERIUT	0
NOVO BËRDË	1
OBILIQ	1
PARTESH	0
PEJË	5
PODUJEVË	2
PRISHTINË	18
PRIZREN	3
RAHOVEC	4
RANILLUG	0
SHTËRPECË	0
SHTIME	4
SKENDERAJ	2
SUHAREKË	4
VITI	4
VUSHTRRI	0
LEPOSAVIQ	0
ZUBIN POTOK	0
ZVECAN	0
TOTAL	74

TRANSPARENCA NË PROKURIM

TRANSPARENCA NË TENDERIM

Kjo shtyllë e Indeksit të Transparençës e mat transparençën e dokumenteve të tenderëve komunale. Në këtë fazë, KDI ka krahasuar katër indikatorë për të parë dallimin në mes të njoftimeve të publikuara në ueb faqet e komunave dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në ueb faqen e KRPP-së ose në platformën e prokurimit elektronik.

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, i cili ishte në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit, si dhe sipas legjislacionit sekondar (A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik) të gjitha njoftimet për kontratë mbi vlerën 1,000€, si dhe të gjitha njoftimet për dhënie të kontratës duhet të publikohen në ueb faqen e KRPP-së. Gjithashtu sipas po të njëjtave dispozita ligjore, njoftimet për blerjet mbi 10,000€ duhet të publikohen në platformën e-Prokurimi. Sipas Udhëzimit Administrativ 01/2015 të MAPL-së mbi transparençën e pushtetit lokal, këto njoftime do të publikohen edhe në ueb faqet e komunave.

Për të vlerësuar nivelin e transparençës në këtë shtyllë, KDI ka matur katër indikatorë, me qëllim të ilustrimit të dallimit ndërmjet ueb faqeve të komunave dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në ueb faqen e KRPP-së janë:

- 1** Numri i njoftimeve për kontratë të publikuar në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2017;
- 2** Numri i njoftimeve për kontratë të publikuar në ueb faqen e KRPP-së (Platformën E-prokurimi) janar-dhjetor 2017;
- 3** Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2017;
- 4** Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqen e KRPP (Platformën E-prokurimi) janar - dhjetor 2017



VËREJTJE: Platforma e-Prokurimi kishte hyrë në fuqi nga janari 2017 për komunat.¹² Gjatë periudhës së tranzicionit janar-mars 2017 publikimi i dokumenteve të tenderit ishte i mundur edhe në ueb faqen e KRPP-së edhe në platformën e prokurimit elektronik. Kjo shkaktoi duplikim të informatave dhe statistika të pasakta për numrin e përgjithshëm të aktiviteteve të prokurimit.

Aktualisht, ende ka një kërkesë hutuese, meqenëse në arkivin e KRPP-së vazhdojnë të publikohen kontratat e dhëna me vlerë minimale, por njoftimet e tjera publikohen në platformën e prokurimit elektronik. Për të shmangur hutimin e mëtejshëm, KDI rekomandon që platforma e E-prokurimit të përdoret në potencialin e saj të plotë dhe që KRPP-së të udhëzoj të gjitha autoritetet kontraktuese që e-Prokurimi të përdoret për publikimin e të gjitha dokumenteve të prokurimit, pavarësisht vlerës së tyre.

13 Vendimi i KRPP numër 11/2016, i datës 29.08.2016



NJOFTIMET PËR KONTRATË


Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqet e Komunave zakonisht dallon shumë për nga numri i tenderëve në ueb faqen e KRPP-së. Shumica e Komunave janë të fokusuar në përmbushjen e kërkesës ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik por mund të mos e përfillin kërkesën e UA të MAPL-së 01/2015 për publikimin e njoftimeve edhe në ueb faqet e tyre.

Bizneset në Kosovë janë në dijeni për platformat e centralizuara; megjithatë, kështu nuk mund të thuhet edhe për qytetarët dhe ndërmarrjet e vogla. Publikimi i njoftimeve të prokurimit në ueb faqet e komunave është me rëndësi për bizneset e vogla lokale dhe qytetarët.

Nga 2,640 njoftime të tenderëve të publikuar në ueb faqen e KRPP-së ose platformën e e-prokurimit, vetëm 542 prej tyre janë publikuar edhe në ueb faqet e komunave. Kjo paraqet vetëm 21 për qind të tenderëve të zhvilluar.

Sa i përket njoftimeve për dhënie të kontratës, nga 2,375 njoftime të publikuara në ueb faqen e KRPP-së dhe platformën e-Prokurimi, vetëm 465 prej tyre janë publikuar edhe në ueb faqet e komunave, Kjo paraqet vetëm 20% e njoftimeve për dhënie të kontratave.

KRAHASIMI I TENDERËVE TË PUBLIKUAR NDËRMJET KRPP DHE UEB FAQEVE TË KOMUNAVE




NUMRI I NJOFTIMEVE PËR DHËNIE TË KONTRATËS






KRAHASIMI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMEVE PËR KONTRATË PËR TË GJITHA KOMUNAT



KRAHASIMI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMEVE PËR DHËNIE TË KONTRATËS



|||||

Komunat me transparencën më të lartë në prokurim publik ishin:

#	KOMUNA	NJOFTIMET PËR KONTRATË JANAR-DHJETOR 2017	NJOFTIMET PËR DHËNIE TË KONTRATËS JANAR-DHJETOR 2017	PËRQINDJA E KOMBINUAR
1	Lipjan	100%	100%	100%
2	Viti	100%	100%	100%
3	Prishtinë	78%	95%	87%
4	Istog	100%	71%	86%
5	Novo Bërdë	71%	53%	62%
6	Kaçanik	64%	53%	59%
7	Kamenicë	100%	0%	50%



VËREJTJE 1: Komuna e Vitisë në modulën ueb faqes zyrtare për njoftimet për prokurime publike kishte të vendosur vegzën (hyperlink) që ndërlidhë me platformën e e-Prokurimit, duke i drejtuar qytetarët e vet në të gjitha njoftimet për komunën. Kjo mund të jetë praktika më e mirë për komunat e tjera.



VËREJTJE 2: Gjatë periudhës janar – dhjetor 2017, komunat e Lipjanit dhe Kamenicës kanë publikuar në ueb faqet e tyre njoftimet për kontratë për blerje me vlera minimale (nën €1,000.00). Edhe pse kjo nuk kërkohet me legjisalcionin aktual, një shpërndarje e tillë vullnetare e informatave të prokurimit shihet si praktikë e mirë.

|||||

TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE

NJOFTIM PËR SHITJE TË ASETEVE

Në Kosovë, numri i ankandeve publike është mjaft i vogël në krahasim me numrin e prokurimeve publike. Edhe pse artikujt të cilët shiten përmes ankandeve nuk kanë vlera të mëdha, prapë se prapë publikimi i këtyre aktiviteteve në ueb faqet e komunave është kërkesë ligjore me Ligjin Nr. 04/L-144 për ndarjen për shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së paluajtshme në komunë.

Përveç kësaj, procedurat e njoftimit për ankandet publike dhe për fituesit e tyre rregullohen me legjislacionin sekondar për prokurimin publik, prandaj kërkohet publikimi i tyre në uebfaqen e KRPP-së.

Për të matur nivelin e transparencës në këtë proces, Indeksi i ka krahasuar katër indikatorët e më poshtëm:

- Numrin e njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2017;
- Numrin e njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e KRPP janar-dhjetor 2017;
- Numrin e njoftimeve për fitues të kontratës të publikuar në ueb faqen e komunës janar-dhjetor 2017;
- Numrin e njoftimeve për fitues të kontratës të publikuar në ueb faqen e KRPP janar - dhjetor 2017.

Respektimi nga komunat i të gjitha kërkesave për publikimin e informatave rreth ankandeve është i ulët. Në vitin 2017, vetëm 7 nga 72 njoftime për ankande të publikuara në ueb faqe të KRPP-së, janë publikuar në ueb faqet e komunave. Nga 43 njoftime për dhënie të kontratës të publikuara në ueb faqen e KRPP, vetëm 4 janë publikuar në ueb faqet e komunave.

Tri komunat e vetme që kanë treguar transparencë në procesin e publikimit të njoftimeve të ankandeve janë komuna e Istogut, Mitrovicës, Rahovecit dhe Vushtrria. Ndërsa katër komunat e vetme që kanë treguar transparencë në procesin e publikimit të njoftimeve për dhënien e kontratave në ankande publike janë komuna e Istogut, Mitrovicës, Gjilanit dhe Kaçanikut.



TË VETMET GJASHTË KOMUNAT QË KANË TREGUAR TRANSPARENÇË NË PUBLIKIMIN E PROCESIVE TË ANKANDEVE PUBLIKE JANË KOMUNA E ISTOGUT, MITROVICËS, RAHOVECIT, VUSHTRRISË, GJILANIT DHE KAÇANIKUT.




10%

7



Numri i njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e komunës

72



Numri e njoftimeve për shitje të aseteve të publikuar në ueb faqen e KRPP

9%

4



Numri i njoftimeve për fitues të kontratës të publikuar në ueb faqen e komunës

43



Numri i njoftimeve për fitues të kontratës të publikuar në ueb faqen e KRPP





INFORMATA PËR ANKESAT NË SHKALLËN E PARË LIDHUR ME PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

Kjo shtyllë trajton procesin e shqyrtimit të prokurimit (ose ankesat në tender). KDI e ka matur transparencën e ankesave në shkallën e parë – dmth, ankesat e adresuara nga vet komunat para eskalimit në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Ligji i Prokurimit Publik është ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068 i cili ka hyrë në fuqi në janar 2016, duke u dhënë të drejtën Autoriteteve Kontraktuese, përfshirë edhe komunat, që ata vet të shërbejnë si shkallë e parë e shqyrtimit të ankesave rreth prokurimit.

KDI ka gjetur se, edhe pse ligji e mundëson shqyrtimin e shkallës së parë, komunat (dhe njësitë e tjera buxhetore në Kosovë) nuk i publikojnë informatat për ankesat në

shkallën e parë. Këto informata janë në dispozicion vetëm për institucionet publike dhe palët ankuese.

Me qëllim të analizimit të llogaridhënies dhe përgjigjeve në vendimet e komunave, Indeksi poashtu ka matur numrin e ankesave që janë parashtruar në OSHP. Sipas informatave të dhëna nga komunat, në vitin 2017, operatorët ekonomikë kanë parashtruar 216 ankesa në shkallën e parë lidhur me prokurimin.

Gjatë të njëjtës periudhë, operatorët ekonomikë kanë parashtruar 442 ankesa në OSHP, përfshirë këtu edhe ankesat për të njëjtat aktivitete të prokurimit për të cilat ankesa ishte adresuar edhe nga komunat si shkallë

LISTA E KOMUNAVE QË NUK KANË KTHYER PËRGJIGJE

1 DRAGASH

2 JUNIK

3 KLLOKOT

4 MITROVIÇË E VERIUT

5 RANILUG

6 SHTERPCË

7 LEPOSAVIQ

8 ZUBIN POTOK

9 ZVEÇAN





e pare, gjë që rrit shqetësimet lidhur me cilësinë dhe profesionalizmin e vendimmarrësve në shkallën e pare, veçanërisht pasi që ato nuk janë publike ose nuk monitorohen nga ndonjë institucion tjetër.¹⁴

Pas shqyrtimit të ankesave dhe hulumtimit të rasteve specifike, KDI vërejtë se autoritetet kontraktuese kishte vërejtur se në shumë raste nuk i kishin adresuar ankesave në mënyrë të kënaqshme.¹⁶

Gjatë 2017-2018, KDI ka pranuar disa ankesa në telefonin e saj pa pagesë nga vitimat ose dëshmitarët e korrupsionit, lidhur me cilësinë e vendimeve komunale për shqyrtimin e prokurimit.¹⁵

Të njëjtat raste ishin dërguar në OSHP për shqyrtim, dhe pas hetimeve, iu ishin kthyer autoriteteve kontraktuese për rivlerësim, duke ngritur kështu pikëpyetje lidhur me cilësinë e konstatimeve fillestare. Mungesa e mbikëqyrjes, cilësia e dobët e zgjidhjes dhe mungesa e transparencës vonojnë kohën e përfundimit të prokurimit dhe kanë ndikime të tjera negative edhe tek autoritetet kontraktuese edhe te operatorët ekonomikë.

14 Deklaratë nga Sami Uka, Anëtar I Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), Tryeza e Rrumbullakët e D+ mbi performancën e OSHP-së dhe KRPP-së, mbajtur me 11 korrik 2018, ora 10:00, Prishtinë

15 Zyra për Avokim dhe Këshillim Ligjor e KDI-së (ZAKL) për viktimat dhe dëshmitarët e korrupsionit: 0800 77 7777 (e paraqitur edhe në ueb faqen e KRPP-së)

16 Numri i Prokurimit VI657-18-025-121; Numri i Prokurimit 622-17-3318-5-1-1; Numri i Prokurimit: 214-18-3864-5-1-1; Numri i Prokurimit: 1020890500-18-3408-1-1-1


Nga 38 komuna të Kosovës, nëntë komuna nuk kanë ofruar përgjigje në kërkesën për informata lidhur me ankesat dhe vendimet e shkallës së parë ankimore lidhur me proceset e prokurimit.

38
KOMUNA



38
KËRKESA PËR
QASJE TË
DËRGUARA

9
NUK JANË
PËRGJIGJUR NË
KËRKESA



29
JANË PËRGJIGJUR
NË KËRKESA





KONKLUZIONE

TË PËRGJITHSHME

Në vitin 2017, komunat ishin ballafaquar me dy ndryshime të mëdha: zgjedhjet lokale dhe vonesat në funksionalizimin e ueb faqeve të reja komunale. Këto dy ngjarje kanë ndikuar edhe në çështjet në vijim:

- Informatat lidhur me buxhetin, auditimin, planifikimin, njoftimet për kontrata, dhëniet e kontratave dhe ankandet janë në dispozicion në platformat e qeverisë qendrore; megjithatë, ligji kërkon nga komunat që të publikojnë këto informata edhe në ueb faqet e tyre. Përveç kësaj, qytetarët do të përfitonin nga mundësia që të mbledhin informata në një vend për të përcjell shpenzimin e buxhetit, auditimin, dhe veprimet e tjera publike që përfshijnë shpenzime publike për të mirën e komunitetit.
- Përderisa komunat janë duke e përdorur plotësisht platformën e e-prokurimit për të publikuar tenderët e prokurimit për të gjitha prokurimet e vogla, te mesme dhe të mëdha, KDI ka vërejtur një trend negativ sa i përket publikimit të dokumenteve të prokurimit në uebfaqet e komunave.
- Komunave të Kosovës u mungojnë kapacitetet për planifikimin e prokurimit dhe nuk konsultohen me qytetarët në procesin e planifikimit.
- Shumë komuna nuk e kanë përmbushur kushtin ligjor të mbajtjes së takimeve publike me qytetarë duke humbur kështu një mundësi për të shpërndarë informata rreth projekteve komunale me qytetarët përfituesë.
- Informata e përgatitura nga komunat siç janë njoftimet për kontratë dhe njoftimet për dhënie kontrate, lehtësisht mund të publikohen në uebfaqet e komunave. Gjithashtu, raportet e Zyres Kombëtare të Au-


ditimit dhe të Thesarit mund të shtohen lehtësisht në uebfaqe të komunave. Këto informata shumë lehtë mund të përdoren për të pasuruar uebfaqet e vetë komunave pa shpenzuar kohë dhe resurse tjera.



QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Ndonëse disa komuna nuk kanë bërë të ditur numrin e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike për 2017, krahasuar me 2016, është shënuar një ulje në numrin e kërkesave të parashtruara në komuna. Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për vitin 2016 ishte 1,080 (duke mbuluar 34 komuna që kanë raportuar), derisa kjo shifër për vitin 2017 bie në 939 që shënon një ulje prej 13%.


Numri i kërkesave për qasje në dokumente





Në vitin 2016, në 34 komuna u parashtruan 287 kërkesa për qasje në dokumente publike në prokurim publik. Ky numër në vitin 2017 u ngrit në 335, që shënon gjithashtu një rritje të numrit të kërkesave prej 14%.

KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE LIDHUR ME PROKURIMIN PUBLIK



Rënia e numrit të përgjithshëm të kërkesave për qasje në dokumente publike mund të tregojë se ka më shumë informata në dispozicion të qytetarëve përmes platformës e-Prokurim ose burimeve tjera.



TRANSPARENCA BUXHETORE


Edhe pse në disa nga indikatorët, Komunitat e Kosovës janë përmirësuar në krahasim me vitin 2016, në përgjithësi Komunitat ende shfaqin një nivel shumë të ulët të transparencës buxhetore. Shumica e komunave nuk bëjnë publike as dokumentet themelore si buxheti apo edhe raporti i shpenzimeve për vitin përkatës. Në ueb-faqe të komunave mungojnë edhe dokumente shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e prokurimit publik, siç janë planifikimet e prokurimit, apo edhe raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit. Lidhur me transparencën e buxhetit, KDI thekson si vijon:

- Komunitat të cilat kanë publikuar buxhetin për vitin 2017 janë: Dragashi, Drenasi, Istogi, Kaçaniku, Kamenica, Lipjani, Malisheva, Mitrovica, Novobërda, Peja, Prishtina, Prizreni, Rahoveci, Shtimja, Skenderaj, Suhareka, Vitia dhe Vushtrria.
- Komunitat proaktive të cilat kanë publikuar planin e tyre të prokurimit janë: Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Podujeva, Prishtina, Rahoveci, Vitia dhe Vushtrria.
- Komunitat të cilat kanë publikuar raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit në ueb-faqet e tyre janë: Dragashi, Drenasi, Lipjani, Malisheva, Prishtina, Prizreni, Rahoveci, Shtimja, dhe Vushtrria.
- Komunitat me numrin më të madh të dëgjimeve publike janë: Prishtina (24), Vitia (24), Rahoveci (17), Lipjani (16), Gjiçani (15) dhe Gjakova (14).





TRANSPARENCA BUXHETORE



TRANSPARENCA NË PROKURIMT

Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04 / L-237, Ligjin Nr. 05 / L-068 dhe Ligjin Nr. 05 / L-092 për Prokurimin Publik, kërkon që të gjitha njoftimet lidhur me procesin e prokurimit publik të publikohen në platformën e-prokurimi, që komunat janë duke e bërë në të gjitha rastet. Megjithatë, sipas Udhëzimit Administrativ të MAPL-së 01/2015 mbi transparencën e pushtetit lokal, këto njoftime duhet po ashtu të publikohen në ueb faqet e komunave.

Një numër i madh i komunave nuk publikojnë në ueb faqet e tyre njoftimet për kontratë apo njoftimet për dhënie të kontratës. Janë 23 komuna, niveli i transparencës të së cilave është 0% në të dy indikatorët e matur në këtë Shtyllë. Krahasuar me 2016, viti 2017 ka shënuar një rënie prej 17% të mesatares së nivelit të përgjithshëm të transparencës, nga 37% në 21%.

Treguesi që mat transparencën në njoftimet për dhënie të kontratës po ashtu ka pësuar rënie prej 17%, nga një nivel mesatar prej 37% në vitin 2016 në 20% në vitin 2017.

Komunat më transparente përsa i përket prokurimit janë treguar ato të Lipjanit, Vitisë, Prishtinës, Istogut, Novobërdës, Kaçanikut dhe Kamenicës.



TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE


Përmes ankandëve komunat zakonisht shesin mallra të konfiskuara apo edhe pajisje të cilat nuk janë të përdorshme nga institucioni. Edhe pse publikimi i njoftimeve në ueb faqet e komunave është kërkesë ligjore përmes Ligjit Nr. 04/L-144 mbi dhënie në shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së palujatshme dhe komunës, kjo kategori mbetet jo-transparente. Komunat më transparente në këtë shtyllë janë ato të Istogut, Mitrovicës, Gjilanit, Kaçanikut, Vushtrrisë dhe Rahovecit.





TRANSPARENCA NË ANKANDE PUBLIKE

ANKANDE



INFORMATAT MBI NIVELIN E PARË TË ANKESAVE LIDHUR ME PROCESIN E PROKURIMIT PUBLIK

Ligji Nr. 05/L-068 i cili plotëson Ligjin primar Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, në Kapitullin III Inicimi dhe Zbatimin Fillestar i Procedurave të Shqyrtimit, ka krijuar një nivel të ri për zgjidhjen e ankesave (shkallën e parë). Qëllimi i përgjithshëm i kësaj shtese është që të rris llogaridhënien në nivel të autoritetit kontraktues dhe të ul numrin e ankesave që parashtrohen në OSHP. Këto ndryshime ligjore nuk e bëjnë të obligueshme publikimin e vendimeve, prandaj, kjo informatë është vetëm në dispozicion të institucioneve publike dhe ankesuesve.

KDI e ka shtuar këtë shtyllë me qëllim të informimit të qytetarëve rreth numrit të ankesave të adresuara në nivelin komunal dhe në OSHP. Sipas informatave të siguruar nga 29 komuna, në përgjigje të anketës së KDI-

së, operatorët ekonomikë kanë parashtruar 216 ankesa në shkallën e parë lidhur me proceset e prokurimit në vitin 2017.

Derisa operatorët ekonomikë kanë parashtruar 216 ankesa në komunë, ata po ashtu kanë parashtruar 442 ankesa në OSHP, përfshirë edhe ankesat për të njëjtat aktivitete të prokurimit për të cilat kanë parashtruar ankesë në shkallën e parë në komunë. Ky nivel i lartë i ankesave në OSHP tregon se autoritetet kontraktuese nuk janë duke i adresuar shqetësimet e operatorëve ekonomikë në shkallën e parë. Për shembull, në komunën e Novobërdës ka pasur zero ankesa në shkallën e parë, por kanë qenë dy ankesa të parashtruara në OSHP. Të vetmet komuna ku numri i ankesave të parashtruara në OSHP ishte më i vogël se sa numri i ankesave të parashtruara në shkallën e parë në komunë ishin Drenasi, Malisheva, Suharkea dhe Vushtrria.



SHTOJCA 1.

LISTA E PYETJEVE QË U JANË DËRGUAR TË GJITHA KOMUNAVE

PYETJA 1

Sa është numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017?

PYETJA 2

Sa është numri i përgjithshëm i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017?

PYETJA 3

Sa është numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017?

PYETJA 4

Sa është numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në Komunën tuaj në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017?

PYETJA 5

Sa është numri i dëgjimeve publike të organizuara nga Komuna e juaj në vitin 2017, gjatë procesit të hartimit të Buxhetit për vitin 2017?

PYETJA 6

Sa është numri i kërkesave/ankesave të Operatorëve Ekonomik për rishqyrtim të vlerësimeve për dhënie të kontratave, i pranuar gjatë viti 2017?

PYETJA 7

Sa është numri i vendimeve (përgjigjeve) ndaj kërkesave për rishqyrtim të vlerësimeve për dhënie të kontratave, i pranuar gjatë viti 2017?

PYETJA 8

A publikoni në ueb faqen e juaj të dhëna të tilla si: raport të auditorit, raport të shpenzimeve, njoftim për kontratë dhe njoftim për dhënie të kontratës?

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

352.073.53"2017"(496.51)(047)

Krasniqi Metushi, Diana
Indeksi i transparencës në prokurimin publik 2017 :
për komunat e Kosovës / Diana Metushi Krasniqi.
- Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2018. –
32 f. ; 25 cm.

ISBN 978-9951-745-20-8

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

